

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

| | |
|-------------------|----------|
| Xhezair Zaganjori | Kryesues |
| Ardian Dvorani | Anëtar |
| Admir Thanza | Anëtar |

në dhomë këshillimi, më datë 13.12.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

Paditës: Pëllumb Çela

I paditur: Shërbimi Informativ Shtetëror

Objekti: *Anullim i Urdhërit nr. 19702, datë 15.01.2013 të Shërbimit Informativ Shtetëror.
Rikthim në vendin e mëparshëm të punës.
Detyrim i palës së paditur për t'i paguar paditësit Pëllumb Çela pagën e pozicionit të tij të punës nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e tij në detyrë.*

Baza ligjore: *Neni 32/a, 153, 154, 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 Kodi i Procedurave Administrative; Ligji nr. 8381, datë 28.10.1998 "Për Shërbimin Informativ Shtetëror"; Ligji nr. 9357, datë 17.03.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ Shtetëror së bashku me ndryshimet".*

Me Vendimin nr. 12280, datë 09.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: *"- Pranimin pjesërisht të kërkesë-padisë së ngritur nga paditësi Pëllumb Çela. – Anullimin e Urdhërit nr. 19702, datë 15.01.2013 të SHISH "Për lirim nga shërbimi" si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. – Detyrimin e palës së paditur Shërbimi Informativ Shtetëror të dëmshpërblejë paditësin Pëllumb Çela me pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit, pagën e 2 muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, me 7.5 paga mujore për vjetërsinë në punë dhe me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, pa shkak të justifikuar. – Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të saj."*

Me Vendimin nr. 2147, datë 15.05.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë ka vendosur: *"- Të shpallë moskompetencën e gjykimit të çështjes civile nr. 3539, datë 17.02.2014 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë."*

Me Vendimin nr. 3137, datë 17.07.2014 Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: *"- Lënien në fuqi të Vendimit nr. 12280, datë 09.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs me datë 17.11.2014 nga pala e paditur, Shërbimi Informativ Shtetëror. Rekursi është njoftuar tek ndërgjyqësit dhe nuk rezulton të ketë kundërrekurs.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I :

Prishjen e Vendimit nr. 12280, datë 09.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimit nr. 2147, datë 15.05.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë, më 13.12.2017

**Nr. 31003-00308-00-2015 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 00-2017- 2615 i Vendimit (887)**